

**RAPORT I MONITORIMIT
KOMUNA E PRISHTINËS
JANAR – DHJETOR 2012**

Ky publikim është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur - KFOS



Copyright © 2013, Iniciativa për Progres – INPO

INPO ka të gjitha të drejtat e rezervuara për këtë botim. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet apo shpërndahet në çfarëdo forme të mundshme pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

Qëndrimet e shprehura në këtë botim janë përgjegjësi vetëm e botuesit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen se përfaqësojnë qëndrimet e donatorit të këtij botimi.

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
METODOLOGJIA	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6-7
TRANSPARENCA DHE QEVERISJA E MIRË NË PRISHTINË.....	8-9
QASJE NË DOKUMENTE PUBLIKE.....	9
PËRFSHIRJA E QYTETAREVE NË VENDIMMARRJE	9-10
KUVENDI KOMUNAL.....	10-11
MBLEDHJET E KOMITETIT PËR POLITIKE DHE FINANCA.....	12-13
MIRATIMET E KUVENDIT KOMUNAL TË PRISHTINË.....	13-14
EKZEKUTIVI I KOMUNËS.....	15
KRYETARI I KOMUNËS.....	15
PROBLEMET MË TE CILAT BALLAFAQOHEN QYTETARËT E PRISHTINË.....	15-16
ADMINISTRATA.....	16-17
ZHVILLIMI EKONOMIK.....	17-18
SHPENZIMET E BUXHETIT PËR VITIN 2012.....	18
BUXHETI PËR VITIN 2013.....	19
INVESTIMET KAPITALE.....	20
LLUKSI	20
ZHVILLIMI URBAN NË KOMUNËN E PRISHTINË.....	20-21
LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE.....	21
HULUMTIMI I REALIZUAR NGA INPO PËR LEJE NDËRTIMI.....	22-23
NDËRTIMI I SHESHEVE.....	23-24
ARSIMI.....	25
SIGURIA NË SHKOLLA.....	25
ÇERDHET.....	25-26

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE.....	26-27
SHËRBIMET PARËSORE SHËNDETËSORE NË KOMUNËN E PRISHTINËS.....	28-29
MIRËQËNIA SOCIALE.....	29-30
KULTURA NË KRYEQYTET.....	31
REKOMANDIMET.....	32
PËR INPO-N.....	33

HYRJA

Ky raport i realizuar nga INPO ka për qëllim vlerësimin e punës së komunës së Prishtinës gjatë vitit 2012. Në Kosovë ndarja e pushtetit lokal nga ai qendror, është bërë më qëllim që pushteti lokal të jetë sa më afër nevojave të qytetarëve, dhe t'i përmbush sa më shumë kërkesat e tyre. Komuna e Prishtinës si e tillë duhet të jetë sa më afër qytetarëve të saj.

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2012 ka arritur sukses në disa fusha, por ka ngecur në disa të tjera. Sukseset e arritura janë në fushën e shërbimeve publike, sepse janë ndërtuar një numër i rrugëve dhe kanalizimeve në lagje të ndryshme në kryeqytet por edhe në zonat rurale. Po ashtu gjatë vitit 2012 komuna e Prishtinës ka ndërtuar disa shkolla, si dhe ka bërë përrurimin për fillimin e ndërtimeve të disa të tjerave. Janë ndërtuar disa terrene sportive në lagje të ndryshme në qytet. Në fushën e Shëndetësisë komuna e Prishtinës ka ndërtuar disa QMF. Shërbimet për qytetarët nga ana e Administratës në komunën e Prishtinës janë në nivel të kënaqshëm. Po ashtu fillimi i ndërtimeve të dy shesheve në qendër të Prishtinës si: "Ibrahim Rugova" dhe "Zahir Pajaziti" janë dy projekte madhore që do të zbukurojnë qytetin e Prishtinës dhe mjetet janë ndarë nga të hyrat vetanake të komunës.

Sa i përket ngecjeve, komuna e Prishtinës edhe këtë vit ka pasur një menaxhim jo mirë të buxhetit, ku ka pasur mbetje rreth 21 milionë euro (në këtë shumë është llogaritur edhe bartja e mjeteve nga viti 2011). Problemin e parkingjeve komuna nuk ka mundur të zgjedh edhe gjatë vitit 2012, sepse është premtuar për ndërtimin e tri parkingjeve nën tokësore, në mënyrë për të shmangur kaosin në qytet. Gjatë dy viteve komuna e Prishtinës ka legalizuar vetëm 105 kërkesa për legalizimin e ndërtimeve pa leje ku numri i përgjithshëm është 6,148. Trafiku Urban është në gjendje jo të mirë për shkak të autobusëve të pakët, dhe shumica prej tyre nuk i plotësojnë as kushtet minimale për të operuar në komunikacion etj.

Me qëllim të adresimit të këtyre problemeve dhe promovimit të vlerave të institucioneve transparente e llogaridhënese, Iniciativa për Progres (INPO) më mbështetjen e Fondacionit kosovar për shoqëri të hapur (KFOS), ka zhvilluar projektin "Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në komunën e Prishtinës". Përmes këtij projekti synohen të arrihen këto objektiva:

1. Përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies në komunën e Prishtinës;
2. Inkurajimin e medieve që të raportojnë për çështje me rëndësi për komunë;
3. Informimin dhe inkurajimin e aktivizmit qytetar në lidhje me zhvillimet në komunë;
4. Avokimi për adresimin e çështjeve me rëndësi për qytetarët dhe problemeve të evidentuara gjatë procesit të monitorimit në komunën e Prishtinës.

METODOLOGJIA

Më qëllim të arritjes së objektivave të saj, INPO ka implementuar në mënyrë sa më të mirë dhe profesionale projektin “Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në komunën e Prishtinës”, ku janë planifikuar aktivitete të ndryshme. Këto aktivitete përmbajnë në vete aktivitete për nxitjen e komunikimit dhe llogaridhënies në mes të institucionit të komunës dhe qytetarëve. Puna e INPO-s përfshinë edhe monitorimin e drejtpërdrejt të punës së organeve komunale, ku përfshihet Ekzekutivi, i cili udhëhiqet nga kryetari i komunës dhe Asambleja komunale.

Për realizimin e këtyre qëllimeve janë të angazhuar hulumtues, detyra e të cilëve është monitorimi respektivisht hulumtimi i realizimit të premtimeve, arritjes së objektivave dhe efikasitetit të punës dhe kjo në kuadër të parimeve të qeverisjes së mirë, transparencës dhe llogaridhënies.

INPO gjatë monitorimit të komunave përdor një metodologji shumë të avancuar dhe profesionale. Këtë metodologji të cilën e përdorim, është e nivelit më të lartë bashkohor dhe e përdorim për të gjitha komunat që i monitoron organizata jonë, kjo metodë përfshinë përmbledhjen e të dhënave, analizimin e dokumenteve zyrtare kur përfshihen buxhetet dhe kontratat publike, intervista dhe monitorim i drejtpërdrejt të politikave publike që udhëhiqen nga komuna.

Po ashtu metodologjinë të cilën INPO e ka përdorur në hartimin e këtij raporti njëvjeçar përfshin elemente të hulumtimit cilësor dhe krahasues. Hulumtimi cilësor përfshin analizimin e legjislacionit në fuqi mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe statutit të komunës, të cilat e ngarkojnë komunën me përgjegjësi dhe detyra të caktuara. Hulumtimi krahasues ka dy dimensionë, krahasimin me standardet e pranuar ndërkombëtare, duke iu referuar kartës Evropiane për qeverisje lokale dhe krahasimin e punës mes komunës së Prishtinës dhe komunave tjera.

Burimet e të dhënave për përpilimin e këtij raporti përfshijnë raportet e monitorimit të INPO-s të përgatitura nga hulumtuesit në terren, analiza të funksionimit të projekteve brenda komunës, analizë të dokumenteve dhe shkresave zyrtare të organeve komunale. Si burim i dytë janë përdorur raportet e punës të organeve komunale, si dhe intervistat e drejtpërdrejta me zyrtarët komunal.

Ky raport njëvjeçar është i dedikuar për performancën e komunës dhe përfshin periudhën Janar – Dhjetor 2012.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Monitorimi i komunës së Prishtinës për periudhën Janar-Dhjetor 2012, ka rezultuar me hartimin e këtij raporti “Komuna e Prishtinës Janar-Dhjetor 2012”. Ky raport është i bazuar në monitorimin sistematik të komunës së Prishtinës në dy fushat kryesore të legjislativit dhe ekzekutivit. Përmbajtja e këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejt nga hulumtuesit e INPO-s, raportet e çdo seance të Kuvendit komunal, raportet e Komitetit për Politikë dhe Financa, intervistat me drejtorët e drejtorive dhe shefat e zyrave, takimet me përfaqësues të ndryshëm të komunës, analiza të proceseve dhe projekteve të komunës.

INPO vlerëson së për këtë periudhë një vjeçare, qeverisja e komunës së Prishtinës ka arritur rezultate në disa fusha të caktuara. Komuna e Prishtinës ka bërë një progres modest në ndërtimin e disa shkollave dhe terreneve sportive, po ashtu ka bërë përmirësime edhe në administratën komunale dhe infrastrukturën lokale. Ndërsa sfida kryesore vazhdon të jetë siguria dhe cilësia në arsim.

Edhe për kundër këtyre të arriturave në këto fusha, në shumë aspekte të tjera nuk ka arritur të bëjë ndryshime dhe situata thuajse është e njëjtë nga viti i kaluar.

INPO vlerëson së komuna e Prishtinës ende po përballet me probleme të natyrave të ndryshme, ndër problemet më të cilat ballafaqohet ekzekutivi, që në këtë rast përbehet nga kryetari dhe drejtorët e drejtorive, janë pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në vendimmarrje, menaxhimi jo i mirë me buxhetin (çdo vit suficit i lartë), nivel i ulët i transparencës për punën e kryetarit, shërbime publike që nuk përmbushin në plotësi kërkesat e qytetarëve.

Kryetari i komunës i cili udhëheq me ekzekutivin, gjatë këtij viti ka bërë disa shkelje ligjore, atë të Ligjit për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësisë, ku nuk ka raportuar për shpenzimet e tre mujorit të parë të vitit 2012. Gjithashtu, kryetari z. Mustafa në shtator të këtij viti, në një udhëtim zyrtar në Britaninë e Madhe ka marr me vete edhe nënkryetarin, që sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, saktësisht nenit 60 ku tregon qartë që nënkryetari vepron në emër të kryetarit në mungesë të tij. Ndërsa vendimet e kryetarit ende nuk vendosën në ueb-faqen zyrtare, ku gjithë qytetarët dhe shoqëria civile mund të informohen.

Gjatë vitit 2012, Kuvendi i komunës së Prishtinës ka miratuar 56 vendime, 2 rregullore si dhe 8 raporte. Prej 56 vendimeve të miratuara, 25 (44.6%) prej tyre janë për fushën e Drejtorisë së Financave dhe Pronës. Kurse për sektorin e urbanizmit janë miratuar 16 (28.5%) vendime. Për shëndetësi dhe mirëqenie sociale janë miratuar 6 (10.7%) vendime, ndërsa për sektorin e shërbimeve publike janë miratuar 3 (5.3%) vendime, për sektorin e arsimit 2 (3.5%) vendime, për drejtorinë e inspektionit 2 (3.5%), si dhe për kadastër dhe kuvend komunal janë miratuar nga 1 (1.7%) vendim.

Legjislativi i komunës së Prishtinës vazhdon të përballet më cilësi të ulët të diskutimeve mbledhjet e asamblesë, e njëjta gjë vlen edhe në mbledhjet e komitetit për politikë dhe financa.

Shumë nga asamblastët nuk debatojnë fare në kuvend, ku për vitin 2012, INPO ka evidentuar dhjetë asamblastët më pasiv: Bajram Selimaj – LDK, Nexhmije Berisha – LDK, Shaip Hajrizi – LDK, Arta Krasniqi – LDK, Luan Jusufi – LDK, Agim Krasniqi – LDK, Avdush Dobratiqi – LDK, Lumnije Rama – PDK, Meliza Haradinaj – AAK, si dhe Valon Hiseni nga AKR-ja.

Komuna e Prishtinës si duket problemin me buxhetin nuk po mund t'i gjej zgjidhje, nga buxheti i aprovuar i vitit 2012, komuna ka mbetje prej 12,543,125 euro ose 20.3%, mirëpo komuna nga buxheti total i saj(mjetet e bartura nga viti 2011) ka mbetje prej 21 milion euro. Komuna e Prishtinës për investime kapitale ka shpenzuar 59.6%, ku kësaj fushe nuk iu është kushtuar vëmendje e duhur, kur i krahasojmë shpenzimet për investime kapitale më atë të pagave dhe mëditjeve vërejmë që linja e pagave është tejkaluar shuma e përcaktuar me buxhet të aprovuar nga Kuvendi i komunës. Sikur komuna t'i kishte kushtuar vëmendje investimeve kapitale, sikur pagave dhe programeve tjera buxhetore atëherë do kishte një ekzekutim më të mirë të buxhetit, e jo një mbetje mbi 20%. Për organizatën INPO shqetësimi më i madh, gjatë gjithë kësaj periudhe prej së ne monitorojmë komunën e Prishtinës, është së komuna nuk është duke e përmirësuar performancën e saj buxhetore.

INPO për vitin 2012, ka arritur t'i evidentoj shumë probleme më të cilat ballafaqohen më së shumti qytetarët e Prishtinës, ku ndër problemet më të mëdha janë: mungesa e parkingjeve, mos efikasiteti i ndërmarrjes publike komunale “Trafiku Urban”, mungesa e çerdheve, procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje, si dhe mbikalimet dhe nënkalimet.

INPO konsideron se Drejtoria e Urbanizimit të komunës së Prishtinës edhe pse i ka hartuar disa plane rregulluese për disa lagje, sa i përket procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, po përballet me vështirësi të mëdha. Deri më tani janë legalizuar 105 objekte, ndërsa janë afër 3,500 kërkesa për leje legalizimi pa i shqyrtuar fare, si dhe 2,000 kërkesa të tjera të pezulluara që priten të rifuten prapë në procedurë për legalizim final. Nëse komuna vazhdon me këtë ritëm, nuk do të arrijë të përmbyll procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, edhe për disa vite.

Arsimi në komunën e Prishtinës, ka shënuar ngritje në infrastrukturën shkollore sidomos me ndërtimin e disa shkollave. Mirëpo përkundër kësaj arsimit në komunën e Prishtinës përballet me probleme të cilësisë, mungesën e shumta të nxënësve, siguria në shkollat e mesme si dhe mungesa e çerdheve. INPO kërkon nga komuna që t'i kushtoj vëmendje të madhe cilësisë dhe nivelit të sigurisë në shkolla.

INPO i njeh meritën komunës së Prishtinës, gjegjësisht Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport për ndërtimet e terreneve sportive si renovimet e terreneve tjera ekzistuese, po ashtu edhe projekteve të tjera si: mirëmbajtja e institucioneve të kulturës, inventari i Bibliotekës së Qytetit “Hivzi Sulejmani”.

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2012, ka arritur sukses në fushën e mirëqenies sociale, INPO e vlerëson si sukses ndërtimin e 50 banesave për familjet e dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës që pa dyshim ndikon në zbutjen e gjendjes ekonomike për këto familje në nevojë. Mirëpo, drejtorja e shëndetësisë vazhdon të përballët me disa probleme, nga buxheti i vitit 2012 ka bartur për vitin 2013 një shumë të mjekteve prej 481,360 euro. Nuk ka arritur që të realizoj brenda vitit 2012 projektet për ndërtimin e QMF-së në fshatin Besi si dhe ndërtimin e dy ambulantave (QMF) në fshatrat Bardhosh dhe Barilevë, ashtu siç kishte paraparë të ndërtohen brenda këtij viti. Po ashtu shëndetësia në Prishtinë përballët edhe me mungesë të stafit, ku shumë pacientë ankohen nga personeli shëndetësor të cilët janë të papërgjegjshëm dhe nuk po arrijnë të përmbushin nevojat e tyre.

Në komunën e Prishtinës edhe përkundër një përmirësimi të lehtë transparencës, ende po vazhdohet edhe me tej më mungesë të saj, kur e dimë që transparenca është një prej parimeve themelore të një qeverisje demokratike. INPO mungesën e transparencës e vlerëson në bazë të mungesës e informacioneve financiare, mos publikimin e kontratave publike, mos rifreskimit e ueb-faqen, mungesën e qasjes në dokumente publike, takimet me drejtorët që realizohen më vështirësi, monitorimi i punës së kryetarit, si dhe pjesëmarrjen e ulët e qytetarëve në vendimmarrje.

Duke u bazuar në kërkesat që i kemi bërë komunës së Prishtinës gjatë vitit 2012 kanë qenë 23 kërkesa, prej këtyre kërkesave, komuna nuk është përgjigjur në 9 kërkesa, mirëpo edhe në shumë kërkesat tona që i kemi dërguar përgjigja ka qenë e mangët dhe jo-informuese.

TRANSPARENCA DHE QEVERISJA E MIRË NË PRISHTINË

Në komunën e Prishtinës po vazhdohet edhe me tej më mungesë të transparencës, kur e dimë që transparenca është një prej parimeve themelore të një qeverisje demokratike. Kur themi se ka mungesë të transparencës bazohemi në mungesën e informacioneve financiare, publikim e kontratave publike, rifreskimit e ueb-faqen, qasjen në dokumente publike, takimet me drejtorët, monitorimi i punës së kryetarit, si dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Sa më i lartë të jetë niveli i transparentes në institucionet publike, aktorët e interesuar do të kenë mundësi të vlerësojnë më mirë qeverisjen e atyre institucioneve. Është e pamundshme një gjë e tillë t'i behët komunës së Prishtinës, sepse përveç se ka një ngecje në këtë fushë, komuna nuk po bën përmirësime sidomos më freskimit e të dhënave në ueb-faqen, ku përveç rubrikës së lajmeve, ku paraqiten aktivitetet e kryetarit, kjo ueb-faqe është e njëjtë që nga 2011-ta.

Ndër parimet më të rëndësishme të demokracisë janë transparenca dhe llogaridhënia, parime këto që sigurojnë se institucionet publike duhet të përmbushin detyrimet e tyre në bashkëpunim sa më të afërt me qytetarët dhe në kuadër të rregullave të parapara me ligj. Këto parime dhe rregulla ligjore përfshijnë informimin e opinionit për punën, krijimin e mekanizmave për kontroll të

punës nga qytetarët, shoqëria civile dhe media dhe përfshirje e qytetarëve në vendimmarrje. Respektimi i këtyre parimeve është përgjegjësi themelore për institucionet publike, të cilat përdorën si njësi matëse për nivelin e demokracisë dhe progresin e arritur.

INPO vlerëson se gjatë monitorimit të kësaj periudhe kohore njëvjeçare, komuna e Prishtinës ka arritur përmirësime sa i përket komunikimit zyrtar përmes zyrës së informimit, e cila krahas funksionimit të mëhershëm tani më ka një funksionalitet më të lartë. Hapja e sporteleve në komunën e Prishtinës për secilën drejtori, ne si organizatë e vlerësojmë si një të drejt për të ulur burokracinë, e cila ka ekzistuar në komunën e Prishtinës. Tani më kërkesat dhe komunikimi i qytetarëve, medieve dhe OJQ-ve mund të bëhet në formë më të drejtpërdrejt me drejtoritë përkatëse. Poashtu nxjerrën e një broshure nga ana e komunës “E drejta për qasje në informata publik” në bashkëpunim me OSBE-në.

Përkundër këtyre që janë bërë nga komuna e Prishtinës, ende është lartë të qenit efikas sa i përket fushës së transparencës. Duke filluar nga ueb-faqja komunale e cila më shumë shërben si një formë e portalit të lajmeve për aktivitetet e kryetarit, duke i lënë nën hije informacionet të tjera relevante që janë për qytetarët dhe për punën e drejtorive të ndryshme.

Drejtoritë komunale gjatë kësaj periudhe kohore Janar–Dhjetor 2012, kanë treguar një shpërfillje të ligjit për qasje në dokumente zyrtare. Këto të fundit vazhdojnë të mos i respektojnë afatet të përcaktuar me ligj për qasje në dokumente zyrtare, për të dhënë përgjigje zyrtare lidhur me kërkesat që ata i pranojnë.

INPO vlerëson se zyra për informim mbanë nivelin më të lartë të transparencën në komunë dhe disa drejtori, ku edhe shumë drejtor të drejtorive është dashur te presim prej më tepër se një muaj për takim apo për qasje në informata publike.

QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE

Duke u bazuar në kërkesat që i kemi bërë komunës së Prishtinës gjatë vitit 2012 kanë qenë 23 kërkesa, prej këtyre kërkesave, komuna nuk është përgjigjur në 9 kërkesa, mirëpo edhe në shumë kërkesat që i kemi marr nga komuna nuk janë të plota.

Kërkesat e INPO-s, zakonisht janë kërkesa që në kushtet normale të një demokracie dhe zbatimi të një niveli të transparencës këto dokumente do të duhej të ishin ueb-faqen e komunës.

Kërkesat e INPO-s ishin kryesisht të ndërlidhur me: raportet e shpenzimeve të tremujorit të parë, raportin gjashtëmujor të të hyrave dhe shpenzimeve, kërkesa për takime më drejtorë të drejtorive komunale, objektivat 6 mujore që i kanë pasur si dhe përmbushja e planit të punës nga ana e drejtorive. Komuna e Prishtinës vazhdon të këtë probleme të vazhdueshme për zbatimin e ligjit për qasje në dokumente publike, duke lënë në të shumtën e rasteve mediat të presin për përgjigje që ato së paku duhet të ishin vizuale në ueb-faqen e komunës.

Komuna e Prishtinës për të rritur nivelin e transparencës në këtë institucion, duhet të zbatoj Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.¹ Se sa po zbatohet ky ligj nga institucionet tona, më së miri e kuptojmë përmes kërkesave zyrtare, që në vazhdimësi INPO u ka bërë komunës dhe Asamblesë komunale, duke mos anashkaluar edhe kërkesat që kanë ardhur nga qytetarët dhe mediat.

PËRFSHIRJA E QYTETAREVE NË VENDIMARRJE

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2012 ka realizuar disa takime me qytetarë në kuadër të nismës për të diskutuar për futjen e kërkesave të qytetarëve në projektbuxhetin e vitit 2013. Këto takime janë mbajtur duke filluar që nga shkolla fillore “ Xhemajl Mustafa”, për të vazhduar me lagjet Mati, Hajvali, Lagjen kodrave e Trimave, Zona e vjetër e qytetit, shkolla e mesme teknike, duke e përmbyllur me debatin e rregullt me qytetarë në sallën e asamblesë komunale, në objektin e vjetër të komunës.²

Iniciativa për Progres ka përcjellur me vëmendje të gjitha takimet e komunës me qytetarë, përgjatë gjithë këtij viti. Takimet publike janë më se të mirëseardhura sepse aty diskutohen politika dhe projekte që janë me rëndësi për qytetarët. Në përgjithësi takimet i vlerësojmë të rregullta, mirëpo INPO bën thirrje që brengat, rekomandimet e qytetarëve të shprehura gjatë kësaj periudhe të përfshihen në agjendën punuese të komunës së Prishtinës.

Gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2013 komuna nuk i ka përfill, shumicën e kërkesave të qytetarëve dhe buxheti është hartuar me disa projekte të vitit 2012.

Vlerësojmë se komuna e Prishtinës duhet të jetë gatshme për një komunikim të shumanshëm me qytetar ku rekomandimet e tyre duhet të merren parasysh. Poashtu komuna e Prishtinës duhet të gjejë rrugë më alternative për pjesëmarrjen e qytetarëve në këto takime publike, pasi që ne kemi vërejtur se në gjitha takimet numri i militantëve partiakë ka qenë më i madh se sa i atyre që kanë diskutuar apo që kanë ardhur për nevojat të tyre.

KUVENDI KOMUNAL

Ligji për vetëqeverisje lokale e definon "*Kuvendin komunal si organin më të lartë në komunë që zgjedhjet drejtpërdrejt nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale*".³ Kuvendi si

¹ Kuvendi i Kosovës, Ligji për Qasje në Dokumente Publike (2010)

² Raporti i Monitorimit të drejtpërdrejt të Takimeve Publike nga monitoruesit e INPO-së

³ Ligji për vetëqeverisje lokale i Republikës së Kosovës, neni 35, paragrafi 4 i disponueshëm në https://mailattachment.googleusercontent.com/attachment/?ui=2&ik=1a44c752dd&vie=att&th=139c4a763e7d1789&attid=0.3&disp=inline&realattid=f_h6x8b03y2&safe& (Qasur në janar 2013)

organi më i lartë i komunës kryesisht miraton vendime dhe rregullore të cilat shërbejnë për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Kuvendi komunal i Prishtinës ka gjithsej 51 anëtarë⁴. Numri i këshilltarëve është në proporcion me numrin e qytetarëve të komunës së Prishtinës. Të gjithë këshilltarët në Kuvendin e komunës së Prishtinës vijnë nga partitë politike dhe përfaqësojnë gjithsej tetë parti. Partia që qeverisë komunën e Prishtinës është LDK-ja e cila i ka 27 këshilltar komunal si dhe kryesuesi i kuvendit të komunës së Prishtinës i cili vjen nga kjo parti.

Partitë e tjera që janë të përfaqësuara në Kuvendin e komunës së Prishtinës janë :AKR-ja e cila ka nëntë këshilltar pastaj vazhdon PDK-ja e cila në fillim kishte shtatë këshilltar mirëpo kjo parti ka mbetur me pesë këshilltar për shkak se këshilltari Flamur Shala kalon nga PDK-ja në LDK kurse Afërdita Veliu nga PDK-ja kalon në Vetëvendosje. Partia tjetër me radhë është AAK-ja e cila ka gjithsej katër këshilltar kurse LDD-ja, Partia e Drejtësisë dhe Vetëvendosja kanë ka dy këshilltar dhe në fund fare Partia e KDTP-së e cila ka një këshilltar në kuvend dhe kjo parti e përfaqëson komunitetin turk në komunën e Prishtinës.

Kuvendi Komunal i cili është organi më i lartë, ka në dispozicion instrumente dhe mekanizma që të kontrolloj ekzekutivin komunal. Mirëpo gjatë monitorimit një vjeçar të Kuvendit Komunal, INPO konsideron se kontrolli i këtij organi ndaj punës së ekzekutivit ka qenë i ulët për disa arsye të natyrës së ndryshme. Së pari këshilltarët që vijnë nga partia e LDK-së, që janë shumicë në kuvend, të cilët janë zgjedhur me votën e lirë të qytetarit, për t'i përfaqësuar interesat e tyre, mirëpo këta këshilltar i mbrojnë më shumë interesat e ekzekutivit dhe partisë së tyre sesa interesat e qytetarëve.

Propozimvendimet dhe propozimrregulloret te paraqitura nga ana e ekzekutivit kalojnë pa hasur në vështirësi nga ana e asamblesë, për shkak se asnjëherë nuk kundërshtohen nga ana e këshilltarëve të LDK-së që e përbëjnë shumicën në asamble.

Është bërë e zakonshme që kur një propozimvendim apo propozimrregullore vihet në diskutim nga ana e kryesuesit te asamblesë, vetëm shefat e grupeve parlamentare e marrin fjalën për të shprehur qëndrimin e tyre se a e përkrahin apo jo propozimrregulloren apo propozimvendimin për të cilën diskutohet.

Shefi i grupit parlamentar të LDK-së, sa herë që e merr fjalën për të shprehur qëndrimin e grupit të tij parlamentar, ai zakonisht e përkrahë çështjen për të cilën debatohet duke thënë se ne si grup parlamentar e përkrahim këtë propozimvendim apo rregullore për shkak se është shumë e qëlluar, është në pajtim me interesat e qytetarëve, është në të mirë të qytetarëve etj., por kurrë nuk ndodhë që ky apo këshilltarë të tjerë nga ky grup parlamentar që të kërkojnë një sqarim shtesë,te propozojnë ndonjë ndryshim apo ndonjëherë të votojnë edhe kundër.

⁴ Për më shumë shih në <http://kk.rks.gov.net/prishtina/Municipality/Assembly.aspx> (Qasur në janar 2013)

Kjo rutina e zakonshme se vetëm shefat e grupeve parlamentare, duhet të marrin fjalën gjatë mbledhjes në Kuvendin e komunës, i ka bërë këshilltarët që të jenë pasivë dhe të shkojnë të papërgatitur në mbledhje, pa i lexuar paraprakisht pikat e rendit të ditës dhe materialet e tjera që do të trajtohen në mbledhje të asamblesë.

Gjatë monitorimit një vjeçar që INPO ka bërë në mbledhjet e kuvendit të komunës, ka vërejtur disa nga asamblistët më pasiv, siç janë :

1. Bajram Selimaj - LDK
2. Nexhmije Berisha – LDK
3. Shaip Hajrizi – LDK
4. Arta Krasniqi – LDK
5. Luan Jusufi – LDK
6. Agim Krasniqi – LDK
7. Avdush Dobratiqi – LDK
8. Lumnije Rama – PDK
9. Meliza Haradinaj – AAK
10. Valon Hiseni – AKR

Sa i përket grupeve të tjera parlamentare që janë pjesë e opozitës në kuvendin e komunës, edhe këta nuk kanë një vizion të qartë për kryeqytetin. Edhe brenda këtyre grupeve parlamentare nuk ngritën çështje të rëndësishme për qytetarët, që ata i përfaqësojnë sepse bëjnë kritika në drejtim të ekzekutivit, vetëm për të kritikuar por nuk ofrojnë ndonjë alternativë më të mirë.

Edhe pse këshilltarët legjitimitetin e marrin nga vota e lirë e qytetarit, me kusht që këta t'i mbrojnë interesat e tyre, mirëpo këshilltarët në komunën e Prishtinës, sa po të zgjidhen si këshilltar, i ndërprejnë kontaktet me qytetarët dhe nuk komunikojnë me ta për së afërmi, se cilat janë problemet me të cilën ata po përballen në mënyrë që për t'i ngritur në kuvendin komunal.

Problem tjetër që e preokupon INPO-në është se komuna e Prishtinës nuk i informon fare qytetarët e Prishtinës për mbledhjet në asamble, përderisa me statut komuna duhet bërë një gjë të tillë. " *neni 38 i statutit thotë që qytetarët duhet të njoftohen përmes: (i) shpalljeve publike në vende më të frekuentuara brenda territorit të komunës, (ii) mediave të shkruara dhe elektronike dhe (iii) ueb-faqes së komunës.*"⁵

Komuna e Prishtinës, kurrë nuk i njofton qytetarët e saj për mbledhjet e radhës, përmes shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara apo përmes mediave të shkruara apo elektronike, të vetmin njoftim që e bënë komuna e Prishtinës, edhe atë një ditë përpara, është një lajmërim në ueb-faqen e saj. Mirëpo edhe ky lajmërim është shumë gjysmak, sepse, shpesh ndodhë, që në

⁵ Për më shumë shih Statutin e komunës së Prishtinës, i disponueshëm në <http://kk.rks.gov.net/prishtina/getattachment/Dokumente/STATUTI-i-Komunes-se-Prishtines-1-.pdf.aspx> (Qasur në janar 2013)

ueb-faqen e komunës, ku vetëm njoftohen se nesër në ora kaq do të mbahet mbledhja në kuvendin e komunës, disa herë pa i cekur fare pikat e rendit të ditës. Kjo është arsyeja që gjatë vitit 2012 nuk ka ardhur asnjë qytetarë, në mbledhjet e kuvendit të komunës.

Duke vepruar në këtë mënyrë, komuna e Prishtinës, bënë shkelje te statutit, që vetë e ka miratuar dhe rregullave të tjera ligjore dhe në këtë mënyrë i shmanget transparencës dhe llogaridhënies që janë dy parimet bazë të demokracisë.

MBLEDHJET E KOMITETIT PËR POLITIKE DHE FINANCA

*"Komiteti për politikë dhe financa është një komitet i përhershëm i cili themelohet nga Kuvendi komunal"*⁶ Komiteti për politikë dhe financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, Kornizën vjetore buxhetore afatmesme, planin vjetor buxhetor afatmesme, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe ndryshim të buxhetit gjatë vitit fiskal si dhe për marrjen e raporteve nga kryetari dhe dorëzimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës."⁷

Komiteti për politikë dhe financa gjatë vitit 2012 ka mbajtur 12 mbledhje. Zakonisht në mbledhjet e komitetit për politikë dhe financa, marrin pjesë anëtarët e këtij komiteti të cilët emërohen nga Kuvendi i komunës. Gjatë monitorimit që INPO ka bërë në këtë komitet ka vërejtur se zhvillimi i mbledhjeve dhe cilësia e debatit nga anëtarët e tij është në nivel të kërkuar, gjithashtu kryesuesi i kuvendit të komunës i cili e kryeson këtë komitet, iu jep hapësirë të gjithë anëtarëve që të bëjnë propozime, ti japin vërejtjet, komentet e tyre etj.

Mirëpo anëtarët e KPF-së që vijnë nga partitë opozitare, janë ankuar se propozimet e bëra nga ta nuk merren kurrë parasysh, nuk behën ndryshimet apo përmirësimet që ata i bëjnë gjatë mbledhjes. Këshilltari Shefqet Sylejmani i cili vjen nga partia AAK dhe që është anëtar i KPF-së në mbledhjen e dhjetë të këtij komiteti ankohet sepse "sipas tij të gjitha propozimet që bënë ai, por edhe të tjerët, nuk ndryshohen apo përmirësohen, dhe në atë mënyrë shkojnë në mbledhjen e radhës në Kuvendin komunal."⁸

MIRATIMET E KUVENDIT KOMUNAL TË PRISHTINËS

Gjatë vitit 2012, Kuvendi i komunës së Prishtinës ka miratuar 56 vendime, 2 rregullore si dhe 8 raporte. Prej 56 vendimeve të miratuara, 25 (44.6%) prej tyre janë për fushën e Drejtorisë së

⁶ Statuti i Komunës së Prishtinës, neni 44.1 i disponueshëm në <http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Dokumente/STATUTI-i-Komunes-se-Prishtines-1-.pdf.aspx> (Qasur në janar 2013)

⁷ Ligji për vetëqeverisje lokale i Republikës së Kosovës, neni 52.2, fq.19

⁸ Raport nga monitoruesit e INPO-së, gjatë mbledhjeve të KPF-së dhe të KK së Prishtinës.

Financave dhe Pronës. Kurse për sektorin e urbanizmit janë miratuar 16 (28.5%) vendime. Për shëndetësi dhe mirëqenie sociale janë miratuar 6 (10.7%) vendime. Ndërsa për sektorin e shërbimeve publike janë miratuar 3 (5.3%) vendime, për sektorin e arsimit 2 (3.5%) vendime si dhe për fushën e inspektionit 2 (3.5%) dhe të kadastrit dhe kuvendit janë miratuar nga 1 (1.7%) vendim.

Pra gjatë vitit 2012 prej 56 vendimeve të miratuar nga Kuvendi i komunës së Prishtinës, 26 janë marr vetëm për sektorin e financave dhe pronës. Prej 25 vendimeve, 10 janë për financa, si dhe vendimi për bartjen e mjeteve nga viti 2011 në vitin 2012, për investimet komunale, për garanci të kthimit të kredisë, për miratimin e buxhetit, për transferim të mjeteve financiare dhe ekonomike etj. Ndërsa 15 vendimet tjera kanë të bëjnë me pronën komunale, siç janë: vendimi për vazhdimin e dhënies së pronës komunale me qira, për dhënien e objekteve në shfrytëzim me pronësi komunale, për shpalljen e ankandeve publike, për shitjen e automjeteve në pronësi komunale etj.

Për sektorin e urbanizmit janë miratuar 16 vendime, 9 prej tyre janë për plane rregulluese si: vendimi për miratimin e Planit rregullues "Zona Ekonomike" në Prishtinë, për fillimin e hartimit të Planit rregullues urban të lagjes "Mati 2", për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues urban të lagjes "Lakrishta", për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues për lagjen "Sofalia" si dhe ndryshimi dhe plotësimi i Planit rregullues për lagjen "Arbëria 3". Kurse 7 vendimet e tjera kanë të bëjnë me caktimin e lokacioneve për objekte të ndryshme si: vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në Prishtinë, caktimi i lokacionit për ndërtimin e tregut të kombinuar, caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore dhe të mesme të muzikës "Prenk Jakova" si dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e shkollës fillore dhe çerdhes së fëmijëve në lagjen "Kodra e Trimave 1".

Në fushën e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale janë miratuar gjithsej 5 vendime si: vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës të Mjekësisë Familjare, miratimi për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Qendrës së Mjekësisë Urgjente, miratimi i listës përfundimtare për ndarjen e banesave, familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës, miratimin e listës përfundimtare për ndarjen e banesave për raste sociale, si dhe miratimin për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për dhënien e banesave të komunës së Prishtinës në shfrytëzim me qira, për rastet me përkujdesje sociale.

Kurse, 7 vendime të tjera janë në disa fusha të ndryshme, ku 3 prej tyre janë në fushën e shërbimeve publike, 2 në fushën e inspektionit si dhe 2 të tjera në fushën e arsimit. Pra fusha më së paku, që janë marrë vendime nga Kuvendi i komunës së Prishtinës është arsimit në nivel lokal, nga ana tjetër cilësia e nivelit të arsimit parauniversitar në komunën e Prishtinës gjatë vitit 2012 ka pas rënje.

Sa i përket rregulloreve, komuna e Prishtinës gjatë vitit 2012, ka miratuar 2 rregullore. Rregulloren për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të

udhëtarëve, si dhe Rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, në territorin e komunës së Prishtinës.

Po ashtu në Kuvendin e komunës së Prishtinës gjatë vitit 2012, janë bërë 8 raporte të ndryshme. 2 raporte kanë qenë të prezantuara nga kryetari i komunës së Prishtinës z. Isa Mustafa. Raporti i punës për vitin 2011, si dhe Raporti i kryetarit të komunës për situatën ekonomike – financiare të komunës dhe për zbatimin e planeve investuese për periudhën janar – qershor 2012. Kurse 6 të tjerë kanë qenë raporte vjetore për komisionarët e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale si: ndërmarrja "Hortikultura", "Termokosi", "Pastrimi", "Ndërmarrja Publike Banesore", "Sport - Marketing".⁹

EKZEKUTIVI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

Kryetari i komunës

Duke u bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligjet të tjera që obligohet komuna t'i zbatoj, ato i japin kryetarit të komunës të drejta të mëdha ekzekutive. Kryetari i komunës së Prishtinës z. Isa Mustafa qysh në fillim të vitit kishte bërë shkelje ligjore duke mos respektuar Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë-LMFPP apo saktësisht nenin 45 të këtij ligji. Ku në këtë nen pika 45.4 sqaron: Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal raporte tremujore të cilat mbulojnë vitin fiskal deri në fund të tremujorit i cili sapo ka përfunduar.

Më 19 shtator 2012, kryetari dhe nënkryetari kanë udhëtuar së bashku në një udhëtim zyrtar në Britaninë e Madhe. INPO vlerëson se edhe më këtë rast kryetari z. Mustafa kishte bërë mos respektim të ligjit për vetëqeverisje lokale, të nenit 60, nen ky i cili tregon qartë kompetencat dhe përgjegjësit e nënkryetarit. INPO ka vërejtur se saktësisht nuk është respektuar pika 60.3 ku thuhet: *Me "kërkesë të kryetarit, Nënkyetari i ndihmon kryetarit në ushtrimin e funksioneve ekzekutive të përditshme dhe vepron në emër të Kryetarit në mungesë të tij".*¹⁰

Opinionin nuk është shumë i njoftuar për punën e kryetarit, edhe pse komuna e Prishtinës thuhet të tërë ueb-faqen ja kushton aktivitetet e kryetarit, mirëpo në këto aktivitetet të cilat publikohen në rubrikën e lajmeve të ueb-faqes së komunës janë vetëm përurimet dhe takimet zyrtare të cilat i realizon në komunë. Asnjë herë nuk tregohen se çka bisedohet në ato takime, rëndësia e tyre, përfitimet e komunës dhe të qytetarëve.

⁹ Të gjitha informatat për miratimin e vendimeve, rregulloreve, prezantimin e raporteve në mbledhjet e Kuvendit të komunës së Prishtinës gjatë vitit 2012, janë marrë nga zëdhënësi për informim z. Asdren Osaj.

¹⁰ Ligji për vetëqeverisje lokale i Republikës së Kosovës, neni 60, pika 60.3

PROBLEMET MË TË CILAT PËRBALLEN QYTETARËT E PRISHTINËS

Gjatë vitit 2012, INPO ka arritur t'i evidentoj shumë probleme më të cilat ballafaqohen më se shumti qytetarët e Prishtinës, ku ndër problemet më të mëdha, ne kemi evidentuar këto probleme të cilat janë më rëndësi jetike.

Mungesa e Parkingjeve

INPO konsideron se mungesa e parkingjeve të pamjaftueshëm në qytetin e Prishtinës është bërë një problem serioz dhe shqetësues për qytetarët e Prishtinës. Komuna e Prishtinës me vite nuk po mund të zgjedh këtë problem dhe nuk ka marrë ndonjë hap serioz në këtë drejtim. Nga ana tjetër komuna e Prishtinës me vite zotohet se këtë problem do ta zgjedh së shpejti duke i ndërtuar tri parkingje nëntokësore, në tri lokacione të ndryshme në qytet.

Mungesa e Çerdheve

Një prej problemeve më të cilat përballen më se shumti qytetarët e Prishtinës është ajo e mungesës së çerdheve. INPO mungesën e çerdheve e cilëson si një ndër problemet më të mëdha në komunën e Prishtinës. Edhe pse ne ndajmë një mendim të tillë rreth këtij problemi, komuna nuk po punon në këtë drejtim. Që dy vite në komunën e Prishtinës nuk janë ndërtuara asnjë çerdhe edhe pse komuna kishte shpallur tender për ndërtimin e këtyre çerdheve, mirëpo nuk ka pasur të interesuar për ndërtimin e tyre

Trafiku Urban

Qytetarët kanë probleme të shumta me udhëtime brena qytetit. Pothuajse të gjithë autobusët janë shumë të vjetër, ku disa prej tyre edhe nuk i përmbushin kushtet për me operu në trafik. Shumë herë ndodhë që gjatë rrugës autobusët të prishen dhe qytetarët duhet pritur autobusin tjetër apo gjejnë ndonjë mënyrë tjetër. Madje autobusët janë të papastër dhe disa herë ju vjen era, gjatë verës kur temperaturat po arrijnë edhe 40 gradë, këta autobusë nuk kanë klimë, kurse gjatë stinës së dimrit nuk ju funksion ngrohja.

Mungesa e Nënkalimeve dhe Mbikalimeve

Mos-ndërtimi i nënkalimeve dhe mbikalimeve është duke shkaktuar probleme të mëdha brenda qytetit, këto probleme më së shumti i prekin qytetarët. Për ta kaluar rrugën shpesh duhet prituri disa minuta, sepse përveç që është komunikacioni i dendur, ekziston edhe problemi i shpejtësisë së veturave në këto rrugë.

INPO e sheh si shumë të nevojshme ndërtimin e nënkalimeve dhe mbikalimeve, sepse me ndërtimin e tyre do të behët një zgjidhje e problemit që i prek të gjitha shtresat e qytetarëve. Me ndërtimin e nënkalimeve dhe mbikalimeve do të ofrohej një lëvizje më e sigurt për qytetarët.

ADMINISTRATA

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2012 ka bërë një progres në administratën komunale, duke investuar në objektet komunale, ku ka rritur efikasitetin e ofrimit të shërbimeve për qytetarë. Përmirësimi i cili është bërë në teknologjinë moderne dhe tashmë çdo drejtori dhe njësi komunale e ka zyrtarin e saj, i cili ofron shërbim të drejtpërdrejt qytetarëve.

Komuna ka funksionalizuar edhe dy zyra të vendit, gjë të cilin INPO e vlerëson si hap pozitiv ofrimin e kushteve më të mira për qytetarët dhe qasje më të lehtë për banorët e zonave rurale. Poashtu edhe gjatë verës, në kohën kur shtohet edhe kërkesa nga qytetarët të cilët jetojnë jashtë vendit, komuna nuk ka pushuar gjatë kohës së drekës dhe ka punuar edhe gjatë vikendeve.

Mirëpo edhe përkundër këtyre të arriturave nga komuna e Prishtinës, në administratën komunale ka ende shumë punë për tu bërë.

Bashkësitë Lokale

Përgjegjësitë e bashkësive lokale janë të ndryshme, dhe po që se të jenë funksionale ashtu si përcaktohet me ligj, ato do të kontribuonin shumë në ofrimin e shërbimeve më afër për qytetarët. Bashkësitë lokale emërojnë komisionet përkatëse për t'i realizuar objektivat e fshatit, vendbanimit dhe lagjes. Evidencojnë dhe paraqesin prioritetet e lokalitetit para organeve të komunës, si dhe të hartojnë planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat.

Komuna e Prishtinës ka gjithsej 33 bashkësi lokale.¹¹ Njëzet këshilla lokale janë të shtrira në qytet kurse trembëdhjetë janë të përqendruara në fshatrat e komunës.

Bazuar në përgjegjësitë dhe rëndësinë që kanë bashkësitë lokale në funksionimin e mirë të qeverisjes lokale në komunën e Prishtinës, INPO shpreh shqetësimin e saj për gjendjen jo të mirë të infrastrukturës së bashkësive lokale. Mungesa e inventarit dhe mjeteve të nevojshme të punës bën që efikasiteti në kryerjen e përgjegjësive ligjore të jetë më i ulët. Sipas shefit të sektorit të bashkësive lokale në komunën e Prishtinës mos funksionalizimi i plotë i bashkësive lokale “*vjen si rezultat i mungesës së mjeteve financiare, ku duhet theksuar se komuna e Prishtinës për vitin 2012 nuk ka ndarë linjë buxhetore të veçantë për këshillat dhe kryetarët e këshillave lokalë*”.¹²

ZHVILLIMI EKONOMIK

Komunat çdo herë duhet të kanë një strategji për zhvillim ekonomik lokal, ku duhet të bazohen në të, për të zhvilluar ekonomikisht atë zonë që kanë në kompetencë të saj. Strategjia për

¹¹ Lista e kryetarëve të Bashkësive Lokale në territorin e komunës së Prishtinës.

¹² Fadil Leci, Shef i sektorit të Bashkësive Lokale në komunën e Prishtinës.

zhvillim ekonomik lokal siguron forcimin e ekonomisë lokale dhe ndërtimin e kapaciteteve vendore. Për fat të keq, komuna e Prishtinës si kryeqendër e Kosovës vitin 2012 e kaloj pa një strategji të tillë. Komuna ka në kompetencë të saj edhe të hartoj politika për zhvillim ekonomik¹³.

Edhe pse komuna nuk kishte një strategji për zhvillim ekonomik lokal, mirëpo për vitin 2012 kishte ndarë 700,000¹⁴ euro drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim. Në kuadër të këtyre mjeteve janë paraparë të realizohen 15 projekte, ku prej tyre janë realizuar 10 projekte, shuma të cilave është 438,233¹⁵ euro. Këto projekte janë realizuar: Përkrahja e fermerëve në blegtori i kushtueshëm 50,000 euro, Meliroimi i livadheve dhe kullosave poashtu 49,950 euro. Këtë vit komuna ka vendosur t'i përkrah edhe kultivuesit e bletëve me 47,120 euro dhe shpeztarët me 30,000 euro, komuna gjithashtu ka përkrahur edhe vaksinimin e gjedheve dhe qenve me 30,000 euro dhe të mbjellat pranverore me 50,000 euro.¹⁶ Analiza e tokës bujqësore 29,525 euro, vaksinimi i gjedheve dhe mbarësimi artificial, si dhe përkrahje e fermerëve për mbjelljen e grurit 100,000 euro.

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishme për zhvillim ekonomik lokal, mirëpo nuk është duke iu dhenë vëmendja e duhur nga ana e institucioneve lokale.

Një prej pikave strategjike që parashih komuna e Prishtinës për një zhvillim ekonomik dhe të mbaj një ekonomi të qëndrueshme është edhe pika e tretë e përcaktuar në Kornizën Afatmesme Buxhetore – KAB. Në këtë pikë strategjike thuhet se do të arrihet zhvillimi ekonomik përmes cilësisë në arsim, përkrahjes së bizneseve dhe bujqësisë. Drejtoria përgjegjëse për zhvillim ekonomik lokal është Drejtoria e Ekonomisë dhe Zhvillimit, mirëpo komuna e Prishtinës më këtë projekt-buxhet, i ka ndarë vetëm 255 mijë euro për vitin 2013. Në vitin 2012 kjo drejtori kishte 700 mijë euro. Më këtë shumë prej 255 mijë euro, kësaj drejtorie iu kanë marr 455 mijë euro.

Komuna e Prishtinës planifikon që edhe përmes bujqësisë të rrisë zhvillimin ekonomik, mirëpo krahasuar me vitin 2012, këtë vit komuna i ka anuluar 6 projekte që i ka subvencionuar në lëmin e bujqësisë. INPO nuk është aspak e kënaqur më këtë planifikim dhe ndarje buxhetore për zhvillimin ekonomik të Prishtinës.

Spektori i bujqësisë paraqet rëndësi të madhe në zhvillimin ekonomik lokal edhe pse ky fakt nuk është duke iu kushtuar vëmendje e madhe nga ana institucioneve, si ato qendrore ashtu edhe atyre lokale.

¹³ <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Ekonomi-dhe-Zhvillim-Lokal.aspx>

¹⁴ Planifikimi i buxhetit të komunës së Prishtinës për vitin 2012

¹⁵ Fexhri Hyseni, intervistuar nga Osman Bllaca, zyrtarë i INPO-s Janar, 2013

¹⁶ Fexhri Hyseni, intervistuar nga Osman Bllaca, zyrtarë i hulumtimit 2012

SHPENZIMET E BUXHETIT PËR VITIN 2012

Komuna e Prishtinës nuk ka performancë të mirë buxhetore. Për këtë performancë është kritikuar edhe më herët nga INPO. Komuna e Prishtinës përveç kritikave që po i merr në hartimin e buxhetit, kritika të mëdha po merr edhe për mënyrën e shpenzimit. Edhe për kundër këtyre kritikave komuna nuk po bën përmirësime në këtë aspekt.

Komuna e Prishtinës buxhetin e viti 2012 e ka shpenzuar 49,233,459 euro apo 79.7% pra komuna ka mbetje prej 12,543,125 euro apo 20.3%. Komuna e Prishtinës për investime kapitale ka shpenzuar 59.6%, ku kësaj fushe nuk iu është kushtuar edhe vëmendje e duhur, kur krahasojmë më atë të pagave dhe mëditjeve ka kaluar mbi 100%. Sikur komuna t'i kishte kushtuar vëmendje sikur pagave dhe programeve tjera buxhetore atëherë do kishte një ekzekutim më të mirë të buxhetit.

INPO është e shqetësuar se si komuna nuk ka arritur t'i planifikoj më mirë punët të cilat behën në investime kapitale, sepse mund të kryhen shumë punë edhe në kohën pranverore për ndërtime të ndryshme. Komuna e Prishtinës tashmë ka bërë traditë që shumicën e buxhetit të shpenzojë në pjesën e fundit të vitit dhe kjo po vjen si pasojë dhe komuna po ka në fund të vitit suficit të lartë.

BUXHETI PËR VITIN 2013

INPO ka parë të nevojshme që të bëjë një krahasim buxhetit e viti 2013 për komunën e Prishtinës, i cili është miratuar në mbledhjen IX-të e Asamblesë Komunale.

INPO gjatë këtij krahasimi, ka vërejtur se me ndarjen shumëve të mjeteve në zëra buxhetor dhe me projektet dhe aktivitetet që janë planifikuar për këtë buxhet nga komuna e Prishtinës, nuk parashihet një zhvillim i mirë ekonomik dhe një jetë më e mirë për qytetarët e Prishtinës.

INPO ka monitoruar pesë dëgjimet/diskutime publike për buxhetin e vitit 2013, të cilat i kishte organizuar komuna. Në këto dëgjime/diskutime, qytetarët kanë pasur kërkesa të ndryshme, ku zyrtarët komunal thuajse nuk i paskan marrë fare parasysh kërkesat e tyre dhe nuk i kanë futur si prioritet të komunës.

Komuna është e obliguar dhe ka përgjegjësi realizimin e kërkesave të qytetarëve, në mënyrë që të rrisë mirëqenien e tyre, duke ofruar shërbime më efikase dhe infrastrukturë të përgjithshme, në mënyrë që të plotësojë nevojat e qytetarëve të komunës së Prishtinës.

Buxheti i komunës së Prishtinës për vitin 2012 ishte 61,741,684 euro, ndërsa për vitin 2013 planifikohet të jetë 63,371,731 euro, pra që është një rritje prej 1,630,047 euro apo shprehur në përqindje 2.64%. Duke u bazuar në atë, që vitin e kaluar kishim një rritje prej 10% të buxhetit total, në këtë vit me rritje prej 2.63%, vërejmë një performancë jo të mirë në raport më rritje të buxhetit.

Në vitin 2012 Drejtoria për ekonomi dhe zhvillim kishte 700 mijë euro. ndërsa për vitin 2013 do të ketë 255 mijë euro, kësaj drejtorie iu kanë marr 455 mijë euro.

Komuna e Prishtinës planifikon që edhe përmes bujqësisë të rrisë zhvillimin ekonomik, mirëpo krahasuar me vitin 2012, këtë vit komuna i ka anuluar 6 projekte që i ka subvencionuar në lëmin e bujqësisë. INPO nuk është aspak e kënaqur më këtë planifikim dhe ndarje buxhetore për zhvillimin ekonomik të Prishtinës.

Duke u bazuar në këtë plan buxhetor shohim se ky buxhet nuk do të krijoj zhvillim, pagat dhe mëditjet do të konsumojnë buxhetin për 21,276,184 euro apo 34.21%.

INVESTIMET KAPITALE

Komuna e Prishtinës për vitin 2013 ka paraparë të shpenzoj 50.24% apo 31,838,299 euro, shumica e projekteve që janë planifikuar të realizohen gjatë vitin 2013, janë projekte të vitit 2012. Tek investimet kapitale kemi një ulje të buxhetit prej rreth 1 milionë euro. Komuna nuk po mund t'i realizojë projektet që cilat vetë po i planifikon dhe çdo vit po duhet shumica e projekteve të bartën vitin tjetër. Projektet të vitit 2012 janë: ndërtimi i rreth-rrotullimit në rrugën magjistrale në fund të Veternikut, Vazhdimi i rrugës “Enver Maloku”, ndërtimi i rrugës”Ndue Përlleshi” e shumë projekte të tjera.

Kësaj shume prej rreth 32 milionë euro mund t'i shtohen edhe pjesa e pashpenzuar e buxhetit të vitit 2012 dhe komuna mund të ketë mjete tjera për investime kapitale.

LUKSI

Si çdo vit tjetër edhe këtë vit zyrtarët komunal kanë menduar pak edhe për luksin. Në linjën për naftë dhe benzinë ka ndarë 290,000 euro, krahasuar për vitin 2012 që kishte 150,000 euro, pra kemi një rritje prej 93.33%. INPO është në dijeni se kemi rritje të çmimit të karburanteve, mirëpo jo rritje të nivelit saqë të dyfishohet buxheti për këtë linjë.

Komuna çdo vit ndanë një shumë prej 100,000 euro për blerje të veturave edhe këtë vit i ka ndarë 100,000 euro për të blerë vetura për nevojat e administratës komunale. Mirëpo këtë vit vetëm përshkrimi e ka ndryshuar nga blerje në furnizim.

Si çdo vit tjetër edhe këtë vit, kemi shpenzime të telefonit prej 100,000 euro. Ku vetëm mbushje telefonit do të shpenzohen 50,000 euro.

TË HYRAT VETJAKE

Komuna e Prishtinës çdo herë ka pasur rritje të hyrave vetjake. Mirëpo si duket nuk do të vazhdoj më një ritëm të tillë, ngase në kornizës afatmesme buxhetore 2012-2014 thuhet se Komuna e Prishtinës për vitin 2012 do të inkasoj 21,752,189 euro pra ka një rritje prej 1,576,267

euro kurse për vitin 2013 21,757,920 euro, pra do të kemi rritje vetën 5,731 euro. Ndërsa për vitin 2014, në kornizën afatmesme buxhetore 2013-2015 parashikohet të këtë të hyra vetjake 21,782,021 euro, pra do të jetë një rritje e të hyrave vetjake vetëm 24,101 euro apo 0,11%.

ZHVILLIMI URBAN NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Drejtoria e Urbanizmit, Mbrojtës dhe Mjedisit për vitin 2012 ka pasur në dispozicion një shumë të fondeve prej 2,860,000 euro. Të gjitha këto fonde janë nga të hyrat vetjake, dhe prej tyre 1,650,000 euro, kanë qenë të destinuara për hartimin e Planeve Rregulluese Urbane, Planin Zhvillimor Urban si dhe për Planin Zhvillimor Komunal.

Gjatë vitit 2012, në Kuvendin e komunës së Prishtinës janë miratuar 6 vendime për planet rregulluese. Vendimi për miratimin e Planit rregullues “Zona Ekonomike“ në Prishtinë. Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues urban të lagjes “Mati 2“, vendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Lakërishta“, vendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Sofalia“, si dhe vendimi për fillimin e ndryshimit dhe plotësimit të Planit rregullues urban të lagjes “Arbëria 3“.

Pavarësisht këtyre vendimeve të miratuara nga plane rregullative por prapë disa lagje të Prishtinës janë pa plane rregullative. Sipas drejtorit të urbanizmit z.Behxhet Musliu lagjet si “Kodra e Trimave 2“ si dhe “Kodra e Trimave 1“, po ashtu një pjesë në mes ë qendrës 1 dhe 2 si dhe “Taslixhe“ dhe “Aktashi“, janë pa plane rregullative.¹⁷

Pra Drejtoria e Urbanizmit gjatë vitit 2012 nuk ka bërë një planifikim të mirë sa i përket planeve rregulluese. Sepse nuk i ka marrë si prioritet të gjitha lagjet të cilat janë pa plane rregullative, nuk ka planifikuar ndryshimin e planeve rregulluese të cilat nuk përkojnë me gjendjen reale. Mos miratimi për planet, rregullative lidhet edhe me vonesat për lejet e ndërtimit, sepse Drejtoria e Urbanizmit nuk mund të jap leje për ndërtim në ato lagje që janë pa plane rregullative. Dhe për këtë efikasiteti i lejeve të ndërtimit është shumë i ulët.

LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE

Qytetarët e Prishtinës janë të zhgënjyer me komunën, konkretisht me Drejtorin e Urbanizmit dhe Sektorin për Legalizim, sa i përket procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje. Për shkak të pritjeve të stërzgjatura që sipas tyre janë të panevojshme. Sepse po behën dy vite që kur komuna ka filluar me fazën e lëshimit të lejeve për legalizimin e objekteve, dhe deri me tani, vetëm një numër shumë i vogël i aplikuesve, janë pajisur me leje legalizimi.

¹⁷ Behxhet Musliu, Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, intervistuar nga hulumtuesi i INPO-së Arben Sylejmani, janar 2013

Në regjistrin e aplikacioneve për legalizim¹⁸, të publikuar nga komuna e Prishtinës, numri i përgjithshëm i aplikuesve për legalizimin e ndërtimeve pa leje është 6,148. Kurse qëllimet e aplikimit janë të ndryshme: si kërkesa për legalizimin e shtëpive, garazheve, mbindërtimeve, depove, objekteve afariste, objekteve kolektive, objekteve të përziera etj.

Mirëpo, pavarësisht vonesave të gjata për t'u pajisur me leje legalizimi, dhe ankesave të qytetarëve përball komunës së Prishtinës. Mirëpo Drejtori i Urbanizmit z. Musliu në intervistën e fundit të realizuar nga hulumtuesi i INPO-së, procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje e vlerëson si të suksesshëm.

"Sipas Drejtorit të Urbanizmit z. Musliu, deri më tani janë legalizuar rreth 105 objekte të ndërtuara pa leje, kurse një numër rreth 300 sosh, janë në proces final për legalizim, vetëm pritjet që palët të kompletojnë dokumentacionin e kërkuar për legalizim. Po ashtu sipas Drejtorit të Urbanizmit deri më tani janë refuzuar rreth 30 kërkesa për shkak se nuk i plotësojnë kushtet minimale për legalizim. Kurse janë pezulluar një numër i madh i kërkesave, i cili sillet rreth 2000".¹⁹

INPO konsideron se arsyet pse ka shumë vonesa në dhënien e lejeve për legalizim, është mungesa e stafit të mjaftueshëm në Drejtorin e Urbanizmit, si dhe mos planifikimi, qysh në fillim, se sa do të zgjatë procesi i legalizimit. Drejtoria e Urbanizmit sikur të kishte planifikuar qysh në fillim kohën, atëherë ky proces do të përfundonte më shpejtë. Por pavarësisht këtyre vonesave Drejtoria e Urbanizmit as tani nuk ka marrë ndonjë hapë konkret, për të zgjedh këtë problem pothuajse të dështuar.

Nëse Drejtoria e Urbanizmit, e shpejton procedurën e legalizimit të ndërtimeve pa leje, përveç që është në të mirë të qytetarëve, është edhe në të mirë të komunës. Sepse secili aplikues që ka aplikuar, për të legalizuar objektin tij të ndërtuar pa leje, duhet të paguaj një shumë në bazë të sipërfaqes së objektit. Sipas drejtorit të urbanizmit z.Musliu *"shuma e përcaktuar për leje legalizimi, të cilën aplikuesi duhet të paguaj është 12 euro për metër katror, për banim individual, deri në 450 metra katror, por nëse tejkalohet sipërfaqja prej 450 metrave katror, atëherë aplikuesi duhet të paguaj 15 euro për metër katror".²⁰* Nëse komuna e Prishtinës i legalizon të gjitha këto kërkesa për leje legalizimi, që në total janë 6,148, atëherë buxheti i komunës do të rritet dukshëm. Pasi që të *"Të hyrat nga lejet e ndërtimit dhe nga tatimi në pronë, janë dy burime kryesore të të hyrave vetjake".²¹*

¹⁸ Për më shumë shih, Publikimin e Regjistrin të Aplikacioneve për legalizim, i disponueshëm në [http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Home/Lendet-e-paraqitura-per-legalizim\(1\)-1.pdf.aspx](http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Home/Lendet-e-paraqitura-per-legalizim(1)-1.pdf.aspx)

¹⁹ Behxhet Musliu, Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, intervistuar nga hulumtuesi i INPO-së Arben Sylejmani, janar 2013.

²⁰ Po aty.

²¹ Për më shumë shih Strategjinë Afatmesme Zhvillimore të komunës së Prishtinës, e disponueshme në [http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Home/Strategjia-1-3-\(3\).pdf.aspx](http://kk.rks-gov.net/prishtina/getattachment/Home/Strategjia-1-3-(3).pdf.aspx) (Qasur në shkurt 2013)

Prandaj INPO konsideron se Drejtoria e Urbanizmit të komunës së Prishtinës, sa i përket procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, ka hyrë në një rrugë që nuk po e gjen dot daljen. Sepse janë afër 3,500 kërkesa për leje legalizimi pa i shqyrtuar fare, si dhe 2,000 kërkesa të tjera të pezulluara që priten të rifuten prapë në procedurë për legalizim final. Nëse komuna vazhdon me këtë ritëm, nuk do të arrijë të përmbyll procesin e legalizimit të ndërtimeve pa leje, të paktën edhe për pesë vite.

HULUMTIMI I REALIZUAR NGA INPO PËR LEJE NDËRTIMI

Në muajin tetor të vitit 2012, INPO ka realizuar një hulumtim me qytetarët e kryeqytetit, të cilët kanë aplikuar paraprakisht në Drejtorinë e Urbanizmit të komunës së Prishtinës, për tu pajisur me leje, e mandej për të filluar me ndërtim. Mirëpo sipas respondentëve të anketuar, edhe ky proces nuk ndryshon shumë nga procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje. Sepse edhe këtu qytetarët hasën me pritje të gjata nga ana e komunës së Prishtinës. Pritje që sipas tyre janë të panevojshme, dhe që po e vështirësojnë ndërtimin për ata që duan të ndërtojnë në qytet.

Në këtë hulumtim kanë marrë pjesë vetëm ata qytetarë të cilët kanë aplikuar për tu pajisur me leje ndërtimi. Numri i respondentëve të anketuar është 62. Ky hulumtim argumenton, se qytetarët të cilët kanë aplikuar në komunën e Prishtinës për t'u pajisur me leje ndërtimi janë shumë të pakënaqur, sepse sipas tyre komuna nuk po i përmbush kërkesat e tyre dhe aq më keq, komuna po vazhdon ende me këtë ritëm neglizhent dhe burokratikë përball kërkesave të tyre.

Bazuar në gjetjet e arritura me këtë hulumtim, 63 për qind e respondentëve të anketuar, të cilët kanë aplikuar për leje ndërtimi, ende nuk janë pajisur për shkak të vonesave të shkaktuara nga Drejtoria e Urbanizmit. 37 për qind prej atyre që janë pajisur me leje ndërtimi, vetëm 21% prej tyre kanë marrur lejen brenda 1 muaji, 33 për qind brenda 3 muaj, 17 për qind për 6 muaj dhe 29 për qind më shumë se 6 muaj.

Ndërsa 63 për qind prej atyre që ende nuk kanë pajisur me leje, rreth 77 për qind nuk kanë marrë asnjë informacion se sa kohë duhet prituri, cila është arsyeja e vonesës etj. Kurse 23 për qind prej atyre që nuk janë informuar, kanë shkuar vetë në zyre të Urbanizmit për të kërkuar informacion se cila është arsyeja e mos dhënies së leje të ndërtimit. Dhe sipas tyre përgjigjet nga Drejtoria e Urbanizmit kanë qenë së ka kërkesa shumë, dhe duhet prituri deri sa lëndët e tyre të trajtohen.

Gjithashtu të dhënat tjera konfirmojnë se 68 për qind e respondentëve të anketuar, mendojnë se Drejtoria e Urbanizmit e komunës së Prishtinës ka procedura shumë burokratike dhe është neglizhente ndaj kërkesave të tyre. Ndërsa 60 për qind e të anketuarve mendojnë se në këtë sektor nuk ka staf të mjaftueshëm dhe profesional për të bërë këtë punë. Respondentët e anketuar pyetjes së fundit në pyetësor se sa janë të kënaqur me komunën e Prishtinës, në lidhje me lëshimin e lejeve për ndërtim, 58 për qind e të anketuarve janë përgjigjur se janë shumë të pakënaqur.

Pra në bazë të këtij hulumtimi, mund të arrijmë në përfundim se Drejtoria e Urbanizmit të komunës së Prishtinës, për lëshimin e lejeve për ndërtim, po e ndjekë të njëjtën procedurë me atë për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Prandaj drejtoria e Urbanizmit të komunës së Prishtinës duhet të jetë më e përgjegjshme dhe t'i përmbushë kërkesat e qytetarëve.

NDËRTIMI I SHESHEVE

Komuna e Prishtinës në fillim të vitit 2012 ka filluar punimet me ndërtimin e dy shesheve. Sheshi i Pavarësisë "Ibrahim Rugova" si dhe sheshi "Zahir Pajaziti". Mirëpo komuna e Prishtinës paraprakisht ka hapur tenderin për të dy sheshet. Tenderi i parë është hapur për Sheshin e Pavarësisë "Ibrahim Rugova". Ky tender është dhënë përmes zyrës së prokurimit. *"Kompania që e ka fitua tenderin për Sheshin "Ibrahim Rugova" është "Allzone& ABC" kurse vlera e përgjithshme e kontratës është 4.365.714,70 Euro. Për këtë tender kanë aplikuar gjithsej 6 kompani."*²²

*"Kurse puna në terren ka filluar me 16 mars 2012. Sheshi ka një hapësirë prej 12 mijë 800 metra katror prej të cilave rreth 4 mijë metra katror janë sipërfaqe e gjelbëruar, kurse punimet në këtë shesh janë paraparë të përfundojnë me 15 gusht 2013."*²³

Poashtu komuna e Prishtinës ka hapë edhe një tender tjetër për Furnizimin dhe montimin e pllakave në sheshin "Ibrahim Rugova", *"kurse fituese për këtë tender janë "All Zone" & "Gërguri" & "Zysken Trans", kurse shuma e përgjithshme e kontratës është 2,279,981,00 Euro."*²⁴

Përrurimi zyrtar për fillimin e ndërtimit të sheshit "Zahir Pajaziti" filloj me 30 korrik 2012 nga kryetari i komunës së Prishtinës. Mirëpo para se me fillua ndërtimi i sheshit, komuna e Prishtinës ka hapur tenderin, për dhënien e kontratës për ndërtimin e sheshit. Kontrata për sheshin "Zahir Pajaziti" është dhënë me 05.12.2011, kurse përfitues të tenderit janë kompanitë "Steda

²² Për më shumë shih Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, i disponuesh në <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=VieëNotices&ID=50116> (Qasur në shkurt 2013)

²³ Për më shumë shih në ueb-faqen zyrtare të komunës së Prishtinës, e disponueshme në <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Neës/Filluan-punimet-ne-Sheshin--Ibrahim-Rugova%E2%80%9D.aspx> (Qasur në shkurt 2013)

²⁴ Për më shumë shih Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik, i disponueshëm në <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=VieëNotices&ID=59022> (Qasur në shkurt 2013)

Kosova&Conex Group“ kurse vlera e përgjithshme e kontratës **4,586,184,27 Euro**.”²⁵ Po ashtu në kontratë parashihet “*Garancioni për pllaka nga prodhuesi minimum 20 vite optimal 20 vite*”.²⁶

Pra në kontratë parashihet garancioni për pllaka të paktën për 10 vite, mirëpo në sheshin “Zahir Pajaziti” disa pllaka vetëm kanë filluar për tu thyer, po ashtu disa pllaka nuk janë vënë në nivel me të tjerat, kështu që është rrezik për qytetarët. Problemi tjetër qëndron se komuna e Prishtinës nuk ka publikua në ueb-faqen e saj zyrtare kontratat me emrat e kompanive që i kanë fituar tenderët, qoftë për ndërtimet e shesheve apo për furnizimin e tyre. Prandaj komuna e Prishtinës duhet të kontrollojë më shumë cilësinë e punës në sheshe, si dhe të publikoj kontratat në ueb-faqen e saj zyrtare, në mënyrë që të informohen më lehtë qytetarët së cilat janë kompanitë që kanë fituar tenderët, cila është shuma e tyre, sa do të zgjasë ai projekt etj.

ARSIMI

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2012, ka realizuar thuajse të gjitha projektet të cilat i ka paraparë, prej tyre disa vazhdojnë edhe vitin 2013. Drejtorisë së Arsimit i’u janë ndarë mjete në shumë prej 20,615,200 milionë euro²⁷. Këto mjete janë ndarë për të gjitha kategoritë e shpenzimeve sa i përket fushës së Arsimit. Komuna e Prishtinës i kushton vëmendje të madhe kësaj fushe dhe viteve të fundit është progres në këtë fushë, sidomos në ndërtimin e disa objekteve shkollore. Edhe në këtë vit janë ndërtuar tri shkolla të mesme, një shkollë fillore, disa anekse dhe salla të edukatës fizike.

SIGURIA NË SHKOLLA

Një nga problemet më të mëdha më të cilat ballafaqohet arsimi në komunën e Prishtinës është siguria në shkolla. Parimisht siguria në shkollat e mesme është në nivelin më të ulët. Këtë konstatim INPO e bën duke u bazuar në incidentet që ndodhën në shkollat e Prishtinës. Problemet të cilat ndodhin në këto shkolla janë të natyrës së rëndë si: plagosje, përleshje, rrahje, therje me thikë, si dhe probleme të cilat vijnë nga grupe të ndryshme huliganesh.

Sjelljet devijonte të nxënësve dhe huliganeve që bredhin rreth shkollave, janë duke u shtuar dita ditës nëpër shkollat e kryeqytetit. Nga sjelljet e tyre, rastet e dhunës janë në rritje.

INPO kërkon nga drejtorja e arsimit që të krijohen mekanizma për parandalimin e akteve të dhunës dhe të këtë bashkëpunim më të madh me Policinë e Kosovës, sepse shkolla është një vend i edukimit dhe i arsimimit dhe duhet te jetë një ambient i qetë dhe i sigurt e jo një ambient i dhunës dhe frikës.

²⁵ Për më shumë shih ueb-faqen zyrtare të Komisionit Rregullatin të Prokurimit Publik, i disponueshëm në <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtIID=VieëNotices&ID=52531> (Qasur në shkurt 2013)

²⁶ Po aty

²⁷ Buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2012

ÇERDHET

Përkundër këtyre progreseve të cilat i ka arritur komuna në këtë fushë, ajo akoma po përballet edhe me halle e probleme të ndryshme.

Një prej problemeve më të cilat përballen më se shumti qytetarët e Prishtinës është ajo e mungesës së çerdheve. Në intervistën e fundit që hulumtuesit e INPO-s kishin me zyrtarët komunal të arsimit²⁸, ku edhe zyrtarët e komunës së Prishtinës pranojnë se është një problem ku edhe komuna e pranon se duhet kohë për zgjidhjes e saj.

INPO mungesën e çerdheve e cilëson si një ndër problemet më të mëdha në komunën e Prishtinës. Edhe pse ne ndajmë një mendim të tillë rreth këtij problemi, komuna nuk po punon në këtë drejtim. Që dy vite në komunën e Prishtinës nuk janë ndërtuara asnjë çerdhe edhe pse komuna kishte shpallur tender për ndërtimin e këtyre çerdheve, mirëpo nuk ka pasur të interesuar për ndërtimin e tyre. Sepse komuna e kishte zgjedhur metodën e ndërtimit me partneritet publiko-privat, ku nuk ka pasur të interesuar për të bashkëpunuar me komunën në ndërtimin e çerdheve.

Interesimi i prindërve për t'i regjistruar fëmijët e tyre në çerdhet publike është jashtëzakonisht i madh dhe në bazë të kritereve të cilat janë për tu pranuar një fëmijë në çerdhe është se fëmija duhet të këtë prindin e punësuar. Ky është edhe një lloj diskriminimi i atyre prindërve të cilët nuk janë të punësuar dhe dëshirojnë që t'i dërgojnë fëmijët e tyre në çerdhe.

Nga 8(tetë)²⁹ çerdhet të cilat janë nën përgjegjësinë e komunës, shtatë prej tyre për vitin 2012 kanë pranuar 150 fëmijë.³⁰

Duke u bazuar në kërkesat e mëdha të prindërve për regjistrimin e fëmijëve të tyre në këto çerdhe dhe pranimin e një numri shumë të ulët të pranimin të tyre, INPO e vlerëson si të nevojë imediate shtimin e numrit të çerdheve në kryeqytet.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale veprimtarin e saj e ushtron duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për shëndetësi, Statutin e komunës, rregulloret komunale, urdhëresat dhe udhëzimet.³¹

²⁸ Arbene Aliu- zyrtare për arsim parafillor dhe fillor, intervistuar nga Osman Bllaca, zyrtarë i hulumtimit korrik 2012

²⁹ Sevdije Abazi – zyrtare e arsimit, intervistuar nga Osman Bllaca, zyrtarë i hulumtimit qershor 2012

³⁰ Arbene Aliu- zyrtare për arsim parafillor dhe fillor, intervistuar nga Osman Bllaca, zyrtarë i hulumtimit korrik 2012

“Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2012 kishte në dispozicion një buxhet prej 8,473,944 euro; 6,719,728 euro nga Granti për Shëndetësi dhe 1,754,216 euro nga të hyrat vetjake të komunës. Nga Granti për Shëndetësi 6,065,177 euro kanë qenë të parapara për Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime si dhe për Shpenzime komunale kurse vetëm 654,555 euro kanë qenë të parapara për investime kapitale. Ndërsa nga të hyrat vetjake shuma për investime kapitale ka qenë 1,444,216 euro, që në total është 2,098,767 euro”.³²

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale nuk e ka shpenzuar të gjithë buxhetin e planifikuar për vitin 2012. Shuma e fondeve të bartura për vitin 2013 është 481,360 euro.

-Për Paga dhe Mëditje buxheti është planifikuar 4,683,000 euro, janë shpenzuar 4,625,000 (98.8%) euro, kurse shuma e bartur është 58,000 euro.

-Për Mallra dhe Shërbime buxheti është planifikuar 1,361,177 euro, janë shpenzuar 122,839 (91.1%) mijë euro, kurse shuma e bartur është 122,338 euro.

-Për Shpenzime Komunale buxheti është planifikuar 261,000 euro, janë shpenzuar 256,299 (98.2%) euro, shuma e bartur është 4,710 euro.

-Për Subvencione dhe Transfere buxheti është planifikuar 70,000 euro, janë shpenzuar të gjitha mjetet 70,000 (100 %).

-Për Investime Kapitale buxheti është planifikuar 2,098,767 Euro, janë shpenzuar 1,781,496 (85.1%) euro, kurse shuma e bartur është 295,820 euro.”³³

Tabela 1.

Programi	Buxheti	Shpenzimi	%
Paga dhe Mëditje	4,683,000	4,625,000	98.8
Mallra dhe Shërbime	1,361,177	1,238,839	91.1
Shpenzime Komunale	261,000	256,299	98.2
Investimet Kapitale	2,098,767	1,781,496	85.1
Subvencione dhe Transfere	70,000	70,000	100.0

³¹ Për më shumë shih në ueb-faqen e komunës, i disponueshëm në <http://kk.rks.gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Shendetesi-Mireqenies-Soc-.aspx> (Qasur në shkurt 2013)

³² Valbon Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, intervistuar nga hulumtuesi i INPO-së. Arben Sylejmani, shkurt 2013

³³ Po aty

Gjithsej	8,473,944	7,971,634	94.6
-----------------	------------------	------------------	-------------

Shuma e bartur për Investime Kapitale për vitin 2013, është 295,820 euro. Këto mjete janë për projektet e kontraktuara për ndërtimin e institucioneve shëndetësore, që kanë filluar brenda vitit 2012 por nuk kanë përfunduar. Projektet e QMF-vë të papërfunduara janë: “*QMF-ja në Besi që është duke u ndërtuar dhe kësti i fundit që duhet paguar është 91,416,11 euro. Ambulanta në Bardhosh dhe kësti i fundit për të paguar është 48,327,00 euro. Ndërtimi i Ambulancës në Barilevë dhe kësti i fundit për të paguar është 71,146,11 euro. Rregullimi i oborrit të QMF-së numër 4 dhe shuma për të paguar është 68,057,84 euro si dhe ndërtimi i QMF-së katër, Aneks kontratë dhe shuma është 16,873,59 euro*”.³⁴

Drejtori i Shëndetësisë z.Valbon Krasniqi, mos realizimin e këtyre pesë QMF-vë brenda vitit 2012, e arsyeton për shkak të disa procedurave që është dashur për t'i ndjekur paraprakisht. “*Në fillim është bërë një kërkesë në Drejtorinë e Kadastrit për parcelën ku kemi planifikuar me ndërtua QMF-në, pastaj kemi bërë kërkesën në Drejtorinë e Urbanizmit për leje ndërtimi. Është hapë tenderi përmes zyrës së prokurimit, ku për shkak të gjitha këtyre procedura, kanë bërë që projektet mos të realizohen brenda vitit 2012 etj*”.³⁵

INPO konsideron se Drejtoria e Shëndetësisë së komunës së Prishtinës, është dashur qysh në fillim të vitit, me fillua me procedurat e lartë përmendura për realizimin e këtyre pesë QMF-vë, në mënyrë që projektet e planifikuara për vitin 2012 të përfundonin po këtë vit.

SHËRBIMET PARËSORE SHËNDETËSORE NË KOMUNËN E PRISHTINËS

Në bazë të ligjit për shëndetësi, përkatësisht neni 18, paragrafi 18.1, komunat sigurojnë zbatimin e kujdesit shëndetësor parësor, duke i dhënë përparësi zbatimit të masave parandaluese nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare.³⁶

Shërbimet parësore shëndetësore, komuna e Prishtinës i ofron përmes QMF-vë si dhe Amulantave. Numri i përgjithshëm i QMF-vë është 14, plus Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare. Kurse Ambulantat gjenden kryesisht nëpër zona rurale dhe numri i tyre është 15. Sipas drejtorit z. Krasniqi “*të gjitha QMF-të si dhe Ambulantat kanë për obligim, për t'i furnizuar pacientët me barna që janë të përfshira në listën esenciale*”.³⁷ Mirëpo në bazë të bisedave të realizuar nga hulumtuesi i INPO-së, me pacientët nëpër disa QMF në Prishtinë, ata

³⁴ Po aty

³⁵ Po aty

³⁶ Për më shumë shih Ligjin për Shëndetësi, i disponueshëm në http://ëëë.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2004_4_al.pdf (Qasur në shkurt 2013)

³⁷ Valbon Krasniqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, intervistuar nga hulumtuesi i INPO-së. Arben Sylejmani, shkurt 2013

thonë se QMF-të ku ata drejtohen për shërbim shëndetësor nuk ofrojnë as një barnë esenciale. Poashtu disa pacientë janë ankuar edhe për sjelljen e personelit mjekësor ndaj pacientëve.

Mos furnizimin e pacientëve me barna esenciale e pranon edhe drejtori z. Krasniqi. *"Sipas tij, sfidë e mëtutjeshme mbetet edhe më tutje furnizimi me barna dhe material tjetër shpenzues nga lista e barërave esenciale. Edhe pse është shënuar arritje e madhe në ngritjen e kapaciteteve planifikuese të barërave dhe materialit tjetër mjekësor nga ana e QMF-ve por, edhe më tutje, furnizimi me barëra dhe material hargjues nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë, edhe pse i përmirësuar këtë vit, mbetet larg plotësimit të nevojave dhe kërkesave të pacientëve të kryeqytetit."*³⁸

Po ashtu pacientët janë ankuar edhe për sjelljen e personelit mjekësor ndaj pacientëve. Sipas tyre punëtorët e personelit mjekësor janë të papërgjegjshëm përball pacientëve. Se a është e vërtetë se disa pacientë ankohen ndaj personelit mjekësor, këtë e pranon edhe vetë drejtori i Shëndetësisë z. Krasniqi. *"Sipas tij, ka ankesa të kësaj natyre, por numri i tyre është shumë i vogël. Komisionet disiplinore në kuadër të QKMF-së trajtojnë me seriozitet çdo rast veç e veç dhe aty ku gjenden fakte për shkelje të etikës profesionale ose mos përmbushje të detyrave profesionale merren masa adekuat. Gjatë muajit dhjetor 2012, janë dhënë vërejtje për shtatë profesionist shëndetësor dhe u janë ndaluar mëditje nga pagat e tyre."*³⁹

Për drejtorinë e shëndetësisë sfidë e vazhdueshme edhe më tej mbetet mungesa e spitalit të qytetit, si dhe kufizimet në punësimin e stafit të ri shëndetësor. Edhe gjatë vitit 2012, stafi shëndetësor prej 135 mjekëve të fushave të ndryshme dhe 47 stomatologëve ka mbetur i njëjtë me vitin paraprak, pavarësisht kërkesave të mëdha për shërbime shëndetësore.

MIRËQENIA SOCIALE

DSHMS gjatë vitit 2012 ka realizuar disa projekte në fushën e mirëqenies sociale, siç janë: Projekti për dezinfektimin hapësinor në Prishtinë. Ky projekt është realizuar me qëllim që të eliminohen insektet të cilat mund të bartin sëmundje ngjitëse tek qytetarët. Ky projekt është realizuar në katër faza: Dezinfektimi në fazën e parë është bërë me 14 deri me 18 qershor 2012. Faza e dytë me 02 deri me 06 korrik 2012. Faza e tretë me 24 deri me 28 korrik 2012. Faza e katërt me 13 deri me 17 gusht 2012. Shuma financiare për realizimin e këtij projekti është 119,000 euro, kurse puna në terren është realizuar nga kompania "Doctor Exterminator D D D".

Projekti për ndarjen e banesave, drejtori z. Krasniqi e vlerëson: *"komuna e Prishtinës gjatë vitit 2012 u ka dhënë në shërbim me qira 50 banesa familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të luftës së UÇK-së. Poashtu janë bërë përgatitjet për fillimin e ndërtimit edhe të 100*

³⁸ Po aty

³⁹ Po aty

banesave të tjera të cilat priten të përfundojnë brenda vitit 2013, ku 50 prej tyre do t'u dedikohen familjeve në asistencë sociale dhe 50 banesa të tjera familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe dëshmorëve të luftës së UÇK-së".⁴⁰

Po ashtu është realizuar edhe projekti për Deratizimin e podrumëve dhe garazhave publike në qytetin e Prishtinës i cili ka filluar të realizohet gjatë muajit shtator të vitit 2012. Si dhe Deratizimi vjeshtor i rrjetit të kanalizimit në qytetin e Prishtinës. Janë trajtuar 4,832 puseta, me rreth 150 km rrjet të kanalizimit.

Gjatë vitit 2012, në sektorin për mirëqenie sociale, ka pasur një numër të madh të kërkesave për mbështetje financiare për familjet e varfra, si për sigurimin e ushqimit, blerjen e barnave edhe nevojave të tjera.

Sipas drejtorit z. Krasniqi:

- 1. Numri i Përgjithshëm i kërkesave të bartura nga viti paraprak është 256.*
- 2. Numri i Përgjithshëm i kërkesave të parashtruar sektorit të MS-së për vitin 2012 është 1,538.*
- 3. Numri i Përgjithshëm i kërkesave të zgjidhura pozitivisht është 834.*
- 4. Numri i Përgjithshëm i kërkesave të zgjidhura negativisht është 461.*
- 5. Numri i Përgjithshëm i kërkesave të pazgjidhura është 243.⁴¹*

Drejtori z. Krasniqi, mos realizimin e të gjitha kërkesave të parashtruar nga ana e qytetarëve për mbështetje financiare, e arsyeton me faktin se mjete e alokuar nga komuna e Prishtinës për zbutjen e gjendjes së rëndë materiale nuk kanë mundur t'i mbulojë të gjitha kërkesat.

DSHMS së bashku me institucionet e tjera siç janë: Kryqi i kuq i Kosovës, Policia e Kosovës, Ministria për Mirëqenie Sociale e cila është përgjegjëse për angazhimin e punëtorëve në Qendra për Punë Sociale, Qendrat për Punë Sociale, Gjykata për Kundërvajtje nuk po mund t'i heqin nga rrugët e Prishtinës personat që kërkojnë lëmosh. Sipas drejtorit z. Krasniqi: *"gjatë vitit 2012, komuna e Prishtinës së bashku më të gjitha këto institucione, kemi marrë disa herë aksione për largimin e personave nga rruga që kërkojnë lëmosh, por problemi qëndron se shumica nga këta persona janë të mitur, merren në pyetje nga dy gjykatës për kundërvajtje por nuk dënohen. Lëmosh kërkuesit janë kryesisht nga komuna e Fushës Kosovës dhe nga Shqipëria. Këta që janë nga Fushë Kosova dërgohen nga Policia e Kosovës në këtë komunë, kurse për të tjerët që janë*

⁴⁰ Po aty

⁴¹ Po aty

nga Shqipëria dërgohen deri në kufi me Shqipërinë, por pas disa ditëve të aksionit, lëmosh kërkuesit prapë kthehen dhe dalin në rrugë.”⁴²

Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2012 nuk ka arritur për të ndërtuar një kuzhinë, ku mund të ushqehen njerëzit e varfër sepse ka njerëz të tillë. Prandaj INPO shpreson që komuna e Prishtinës që gjatë vitit 2013 të ndërtoj një kuzhinë ku mund të ushqehen njerëzit e varfër, t’i largoj lëmosh kërkuesit nga rruga si dhe të ndaj mjete më shumë nga buxheti për njerëzit e varfër që kanë nevojë për mbështetje financiare.

KULTURA NË KRYEQYTET

Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport – DKRS, për vitin 2012 iu kishte ndarë një buxhet prej 1,918,000 euro për investime kapitale, ku kishte planifikuar disa projekte dhe aktivitete të ndryshme. Prej të gjitha projekteve dhe aktiviteteve të cilat i kishte paraparë, thuajse se të gjitha janë implementuar dhe realizuar nga DKRS⁴³.

Poashtu edhe shuma nga subvencionet të cilat i kishte në dispozicion DKRS-ja, janë subvencionuar në shumë projekte që janë më rëndësi për jetën kulturore në kryeqytet. Ndër projektet më të rëndësishme të subvencionuar janë: 87 botime, 31 manifestime, 16 festivale, 10 ekspozita, 8 promovime si dhe 7 shfaqje. Gjithsej subvencione për vitin 2012 janë bërë 111,700 euro, ndërsa investime kapitale 1,300,965 euro.

INPO i njeh meritën komunës së Prishtinës, gjegjësisht DKRS për ndërtimet e terreneve sportive si renovimet e terreneve tjera ekzistuese, poashtu edhe projekteve te tjera si: mirëmbajtja e e institucioneve të kulturës, inventari i Bibliotekës së Qytetit “Hivzi Sulejmani”⁴⁴.

⁴² Po aty

⁴³ Takim me znj. Vlora Dumoshi Drejtoreshë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 23 janar 2013, intervistoi Osman Bllaca

⁴⁴ Takim me znj. Vlora Dumoshi Drejtoreshë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, 23 janar 2013, intervistoi Osman Bllaca

REKOMANDIMET

- Të hartoj një strategji për zhvillim ekonomik lokal dhe jetë e ndërtuar nga të gjithë partnerët relevantë dhe në bazë të një vizioni të përbashkët;
- Të behët menaxhimi dhe shpenzimi i mjeteve në mënyrë më të mirë nga ana komuna;
- Të krijohet një komision i veçantë për kontrollimin e investimeve kapitale;
- Të jetë me transparente në shpenzimet e komunës dhe të funksionoj(freskoj më të dhëna) ueb-faqja e komunës;
- Të funksionojnë më mirë bashkësitë lokale;
- Të rritet pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje;
- T'i ketë prioritet parkingjet, trafikun urban, çerdhet, nënkalimet dhe mbikalimet;
- Të gjithë këshilltarët të jenë më të zëshëm në mbledhjet e Kuvendit të komunës, dhe të kontribuojnë sa më shumë sa i përket interesave të qytetarëve, e jo të flasin vetëm shefat e grupeve parlamentare;
- Drejtoria e Urbanizmit të gjejë ndonjë alternativë për shpejtimin e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje, si dhe të panifikoj kohën në të ardhmen për këtë proces;
- Komuna e Prishtinës të kontrollojë punimet në dy sheshet për shkak të cilësisë së punimeve;

PËR INPO-N

INPO është themeluar në vitin 2005 duke implementuar aktivitete që kanë ndihmuar integrimin e qytetarëve në proceset sociale dhe vendimmarrëse. Pas tri vite punë efektive, duke e parë të rëndësishme profilizimin e INPO-s, kemi përcaktuar fushën e politikave publike, si qëllimin bazë të punës së organizatës.

Edhe pse në INPO, në fillim të aktivitetit të saj, shumica e stafit kanë qenë pa përvojë të mjaftueshme në menaxhim dhe fushën e politikave publike, kemi arritur të dëshmojmë përkushtim dhe seriozitet në punën tonë. Në mbështetje të konsultimeve dhe disiplinës në punë; përmes performancave artistike protestuese, debatit, fushatave të avokimit, kemi arritur të ndryshojmë strategjitë dhe rregulloret jo-funksionale të institucioneve qeveritare lokale. Më tutje, ne kemi fituar respektin dhe besimin e qytetarëve duke ndërmjetësuar dhe lehtësuar në zgjidhjen e problemeve ose konflikteve administrative me qeverinë lokale.

Përgjatë shtatë viteve të punës intensive ne kemi ndërtuar raport të shkëlqyeshëm me mediat si dhe partneritet me organizata të ndryshme, duke qenë anëtar të disa rrjeteve të rëndësishme në Kosovë. Stafi i INPO-s është rritur, duke mundësuar kështu edhe rritjen e zonave të monitorimit, në më shumë komuna të Kosovës dhe duke zgjeruar programet e veprimit. Synimi që të jemi pjesë e rrjeteve rajonale është arritur dhe INPO do të vazhdojë të përmbush këtë qëllim, gjithmonë duke ruajtur raportet e mira me partnerët aktual.

Avokimi dhe fushatat sensibilizuese në fushën e politikave publike, përbëjnë aspektin më të suksesshëm të punës së organizatës gjatë këtyre shtatë viteve. Ne synojmë të jemi një partner konstruktiv në të gjitha proceset në kuadër të fushës sonë të veprimtarisë.

**PROJEKTI I MONITORIMIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS DHE
PUBLIKIMI I KËTIJ RAPORTI ËSHTË PËRHRAHUR NGA: FONDACIONI I
KOSOVËS PËR SHOQËRI TË HAPUR – KFOS.**



**INICIATIVA PËR PROGRES - INPO
RRUGA "HALIL ALIDEMAJ" | PRISHTINË, 10000 KOSOVË
TEL: +381 (0) 38 220 552 | +377 (0) 44 130 285
WWW.INPO-KS.ORG | E-MAIL: INFO@INPO-KS.ORG**